



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1463/2 Prot.

Pukë, më 04.09. 2025

V E N D I M

Nr. 27 , datë 04.09.2025

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL TE BASHKISE PUKE 2025-2028”**

Në zbatim të nenit 55,64,të ligjit nr.139/2015” “Për Vetëqeverisjen vendore” ,ligjit 9669 date 18.12.2006 ‘Per masa ndaj dhunes ne marredhenje familjare’ i ndryshuar,VKM nr.334 date 17.02.2011 ”Per mekanizmin e bashkerendimit te punes per referimin e rasteve te dhunes ne marredhenjet familjare dhe menyren e procedimit te tij’,Ligjit nr.18/2017 “Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes. Ligji nr.9970,date 24.07.2008 “Per barazine gjinore ne shoqeri’ Ligji 10221,date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”,neni 36 i Ligjit nr.121,date 21.11.2016”**Per sherbimet e kujdesit shoqeror ne Republiken e Shqiperise**” Vendimi nr.152 date 13.03.2024 ,te Keshillit te Ministrave “Per Miratimin e Strategjise Kombetare te mbrojtjes sociale 2024-2030 dhe planit te veprimit ne zbatim te saj,VKM nr.150 date 20.03.2019 “Per metodologjine e llogaritjes se Fondeve per Financimin e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror”,,Sektori I ndihmes ekonomike dhe sherbimit social me propozim te Kryetarit të Bashkisë, , Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit në mbledhjen e tij të datës 04.09.2025;

VENDOSI:

1. Të miratoje “Planin Social të Bashkisë Pukë 2025-2028, bashkëlidhur ketij vendimi.
2. Për ndjekjen e zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, sipas përkatësisë të gjitha drejtoritë dhe sektoret .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit **55,pika 6** , e ligjit nr.**139/2015** “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
4. Vendimi u shpall me date 04.09.2025.
Vota te vlefshme gjithsej 9
Vota pro 9 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0.

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 587/1
prot

Shkoder, më 10.09.2025



LËNDA: Mbi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pukë Nr.27, datë 04.09.2025.

KËSHILLIT BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18, 24, neni 54 germa k, neni 55/2, ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” neni 36 pika 1/c, VKM Nr.111/2018 “Per krijimin dhe funksionimin e fondit social”, dokumentacionit të sekretarit të KB Pukë nr.1482/4 prot, datë 08.09.2025, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pukë Nr.27, datë 04.09.2025 “Mbi miratimin e planit social vendor në Bashkinë Pukë për 2025-2028”.

Prefekti konstaton se në mbështetje të ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” neni 36 pika 1/c, Këshilli Bashkiak ka tagrin të miratojë një plan social vendor¹.

Për sa trajtuar, referuar Urdhërit të Prefektit për delegim Nr.62, datë 28.08.2025, ju autorizohet të procedohet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

NË MUNGESË DHE DELEGIM

NËNPREFEKTI

Hysen HYSAJ

¹ Sipas propozimit të organit ekzekutiv

PLANI SOCIAL VENDOR

BASHKIA PUKË

2025-2028



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike "Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Pukë, zbatuar nga GOPA Ëorldeide Consultants.

Shkurtime

AK	Aftësi të Kufizuara
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizat Jo Qeveritare
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
NE	Ndihmë Ekonomike
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVVRN	Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
PSV	Plani Social Vendor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UMM	Urdhër i Menjërshëm Mbrojtjeje
UM	Urdhër Mbrojtje

Contents


I. Hyrje	4
II. Metodologjia për Hartimin e Planit	4
III. DIAGNOZA	6
1. Diagnoza për kategoritë në nevojë	7
2. Diagnoza e sherbimeve shoqërore	38
3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Pukë	45
4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Pukë	49
5. Analiza SËOT	49
IV. Vizioni, Misioni, Prioritetet Strategjike dhe Objektivat	49
V. Plani i Veprimit	56
VI. Finalizimi i Planit Social Vendor	58
VII. Monitorimi dhe Vlerësimi (1–2 faqe)	58
VIII Shtojca	59
Shtojca 1 Kuadri legjislativ	59
Shtojca 2 Persona burimore dhe profesionistë lokalë për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësisht administrative	60
IX ANEKSE	60

I. Hyrje

II. Metodologjia për Hartimin e Planit

Metodologjia për hartimin e Planit Social Vendor të Bashkisë Pukë është ndërtuar mbi parimet e pjesëmarrjes, bazimit në të dhëna dhe orientimit drejt rezultateve, në përputhje me 'Guidën Kombëtare për Hartimin e Planit Social Vendor 2025'. Procesi është strukturuar në tre faza kryesore që kanë mundësiar përfshirjen e gjerë të aktorëve lokalë dhe përdorimin e instrumenteve të standardizuara.

Fig 1 Tri fazat kryesore të metodologjisë për hartimin e Planit Social Vendor



Faza I:

- ❖ U krijua Komiteti Drejtues dhe Grupi Teknik me përfaqësues nga bashkia dhe institucionet lokale si AKPA, ZVA, ISSH, Drejtoria Rajonale e SHSSH, etj.
- ❖ U hartua harta e aktorëve dhe u ndërtua një bazë e dhënash për shërbimet ekzistuese.
- ❖ U realizuan 5 intervista me drejtues institucionesh për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për përmirësim.
- ❖ U zhvilluan 3 fokus grupe në qytet dhe në njësi administrative, me përfitues dhe jo-përfitues të shërbimeve.
- ❖ U grumbulluan të dhëna statistikore dhe dokumentare nga burime vendore dhe qendrore.

Faza II:

- ❖ Të dhënat u analizuan përmes mjeteve vizuale dhe analizës SĖOT për çdo kategori vulnerabël.
- ❖ U organizua një seminar konsultativ me rreth 56 pjesëmarrës për të diskutuar prioritetet sociale.
- ❖ U hartua dhe u miratua raporti diagnostikues nga grupi teknik dhe Komiteti Drejtues.
- ❖ Të dhënat krahasuese për periudhat 2022 dhe 2024 u përdorën për të mbështetur analizën.

Faza III:

- ❖ U ndërtuan fletëveprimi për çdo objektiv specifik, duke përfshirë aktivitete, tregues, burime dhe partnerë.
- ❖ U zhvilluan takime me Komitetin Drejtues për planifikimin buxhetor dhe afatet trevjeçare.
- ❖ U organizua takim me donatorë dhe OJF për të diskutuar mundësitë e bashkëfinancimit.
- ❖ Plani u miratua nga Këshilli Bashkiak dhe u prezantua për komunitetin për transparencë.

Qasje metodologjike

- Përdorimi i një strukture të testuar në 5 bashki të tjera.
- Instrumente të standardizuara për mbledhjen, analizën dhe dokumentimin e të dhënave.
- Pjesëmarrje e gjerë me rreth 111 individë përmes intervistave, fokus grupeve dhe aktiviteteve konsultative.

Fig 1 Pjesëmarrja në procesin konsultativ për hartimin e Planit Social Vendor




Figura 1 paraqet përfaqshinjen e aktorëve lokalë në fazat kyçe të procesit të hartimit të planit, duke reflektuar angazhimin e Komitetit Drejtues, Grupit Teknik dhe komitetit lokal përmes fokus grupeve dhe seminarit konsultativ.

III. DIAGNOZA

Ky dokument përmbledh tre diagnoza kryesore të realizuara në kuadër të Planit Social Vendor të Bashkisë Pukë:

1. Diagnozën për kategoritë në nevojë,
2. Diagnozën për shërbimet shoqërore,
3. Diagnozën për infrastrukturën e ofrimit të shërbimeve dhe aksesit nga kategoritë në nevojë.

1. Diagnoza për kategoritë në nevojë

Sipas Censit 2023, Bashkia Pukë ka një popullsi rezidente prej 6,222 banorësh, me një strukturë që pasqyron qartë tendencën e plakjes demografike. Rreth 20% e banorëve janë mbi 65 vjeç, përqindje që tejkalon ndjeshëm mesataren kombëtare dhe nënvizon domosdoshmërinë e politikave të dedikuara për moshën e tretë. Grupi në moshë pune (15–64 vjeç) përbën 66% të popullsisë, ndërsa vetëm 13.7% janë fëmijë nën 15 vjeç, çka dëshmon për një natalitet të ulët dhe një potencial të dobët për rigjenerim natyror të komunitetit në vitet e ardhshme.

Përtej këtyre të dhënave, bie në sy diferenca e ndjeshme mes popullsisë së numëruar nga Censi 2023 dhe asaj të regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile më 1 janar 2024, e cila rezultoi 14,352 banorë. Vetëm 43% e tyre janë realisht rezidentë në territor, duke reflektuar një nivel shumë të lartë emigrimi të brendshëm dhe jashtë vendit. Grupmosha më e prekur është ajo 0–14 vjeç, me një ulje prej 66%, e ndjekur nga grupi 15–64 vjeç me 59% më pak, çka tregon dobësim të strukturës familjare dhe të forcës punëtore. Edhe pse rënia në grupmoshën 65+ është më e moderuar (–26%), ky grup mbetet veçanërisht i ekspozuar ndaj vetmisë dhe mungesës së përkujdesjes familjare.

Në këtë kontekst, Bashkia Pukë përballët me sfida të mëdha që kërkojnë një riorientim strategjik të planifikimit social, duke synuar forcimin e shërbimeve për një popullsi të plakur, mbështetjen e familjeve me fëmijë dhe krijimin e kushteve të favorshme për qëndrimin dhe rikthimin e të rinjve në territor. Njëkohësisht, është thelbësore ngritja e një sistemi të besueshëm për monitorimin e popullsisë rezidente, në mënyrë që planifikimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale të mbështeten mbi të dhëna reale, të sakta dhe të përditësuara për banorët që jetojnë aktualisht në territor.

1.1 Diagnoza për familjet në nevojë

Identifikimi dhe mbështetja e familjeve në nevojë përbën një komponent kyç të politikave të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Në një territor me sfida të theksuara ekonomike dhe gjeografike si Bashkia Pukë, nevoja për një analizë të saktë dhe të diferencuar të kësaj kategorie është thelbësore për ndërtimin e ndërhyrjeve efektive. Kjo diagnozë synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të shpërndarjes,

tipologjisë dhe boshllëqeve në mbështetjen ekzistuese për familjet në nevojë, duke shërbyer si bazë për planifikimin e shërbimeve më të integruara dhe gjithëpërfshirëse në kuadër të Planit Social Vendor.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore


Familjet në nevojë përfaqësojnë një nga kategoritë më të cënueshme në Bashkinë Pukë, të ekspozuara ndaj varfërisë afatgjatë, përjashtimit social dhe mungesës së mundësive për përmirësim socio-ekonomik. Këto familje përballen me papunësi të lartë, të ardhura të pamjaftueshme, strehim të pasigurt dhe mungesë të aksesit në shërbime të integruara mbështetëse. Shumë prej tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuara, gra kryefamiljare, të moshuar ose të rinj që nuk janë të përfshirë në arsim apo punë.

Zonat rurale të bashkisë, ku aksesimi i shërbimeve është më i vështirë dhe mundësitë për punësim janë të kufizuara, përbëjnë territorin më të rrezikuar për përjetimin e varfërisë së shumëfishitë, me pasoja të dukshme në mirëgenien afatgjatë të familjeve.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Sipas të dhënave të vitit 2024, në Bashkinë Pukë janë identifikuar gjithsej 306 familje në nevojë, prej të cilave 272 përfitojnë nga Skema e Ndihmës Ekonomike (NE) dhe 34 familje përfitojnë nga fondi 6% i buxheut vendor. Shpërndarja sipas njësive administrative tregon përqendrim më të lartë në Qerret (73 familje), Gjegjan (66), Qelez (64) dhe Pukë (57), që përktojnë me zona më të thella dhe me burime të kufizuara për përfshirje sociale dhe ekonomike.

Fig. 1 Familje përfituese të NE sipas njësive administrative




Të dhënat tregojnë se familjet përfutuese nga ndihma ekonomike janë të përqendruara kryesisht në zonat më të thella dhe me akses të kufizuar në shërbime, si Qerret, Gjegjan dhe Qelëz, duke reflektuar lidhjen mes varfërisë dhe izolimit gjeografik.

Në total, 775 persona jetojnë në këto familje përfutuese të ndihmës ekonomike, përfshirë: 199 fëmijë 0–15 vjeç, 77 të rinj 16–18 vjeç, 461 të rritur 19–67 vjeç dhe 18 persona mbi 67 vjeç. Këta përbëjnë rreth 12.5% të popullsisë totale të Bashkisë Pukë, e cila sipas Censit 2023 numëron 6,222 banorë. Kjo përqindje e konsiderueshme tregon një nivel të lartë të varësisë nga ndihma ekonomike dhe thekson nevojën për politika të integruara që i kapërcejnë kufijtë e mbështetjes financiare, duke përfshirë aksesin në arsim, shëndetësi, strehim dhe mundësi punësimi.

Fig Struktura e moshës së përfutuesve të ndihmës ekonomike

PERFITUES TË NE SIPAS GRUPMOSHËS



Struktura e moshës së përfutuesve nxjerr në pah përqindjen e lartë të fëmijëve dhe të rinjve, duke theksuar nevojën për shërbime të integruara që mbështesin zhvillimin dhe përfshirjen e këtyre grupmoshave në sistemin arsimor dhe në jetën sociale.

Të dhënat tregojnë gjithashtu një rënie të numrit të përgjithshëm të familjeve përfutuese nga Skema e Ndihmës Ekonomike në vitin 2024 krahasuar me vitin 2022 (nga 327 në 258 familje). Ky trend, i lidhur me nivelin e lartë të emigrimit dhe lëvizjes së popullsisë drejt zonave urbane apo jashtë vendit, ndikon në strukturën demografike dhe e vështirëson ndërtimin e politikave afatgjata për zhvillim dhe përfshirje sociale në Bashkinë Pukë.

Në vitin 2024 janë evidentuar gjithashtu disa kategori përfutuese specifike nga NE që kërkojnë mbështetje të diferencuar: 2 individë me status jetimi, 8 viktima të dhunës në familje, 4 fëmijë të vendosur në familje kujdestare. Mungesa e përfutuesve në disa kategori të ndjeshme mund të jetë tregues i boshllëqeve në mekanizmat lokalë të identifikimit dhe referimit të rasteve.

Fig. Kategori specifike përfutuese nga ndihma ekonomike (NE)





Figura eidenton kategori vulnerabël përftuese të NE, duke theksuar nevojën për mbështetje të diferencuar përtej asistencës financiare

24.81% e familjeve përftuese të NE janë familje me situatë sociale (5% kanë grua k/familjare, 16.3% e familjeve kanë anëtarë me AK, 3.5% janë vajza nëna)

Në aspektin e strukturës familjare, familjet me 2 deri në 5 anëtarë përbëjnë shumicën e përftuesve të NE, duke reflektuar një tipologji të zakonshme familjare në zonë. Ndërkohë, familjet me më shumë se 6 anëtarë përbëjnë vetëm 8%, por përballen me nevoja më të mëdha për mbështetje arsimore, përkujdesje dhe përfshirje në tregun e punës.

Fig Struktura sipas numrit të anëtarëve të familjeve përftuese nga Ndhima Ekonomike

STRUKTURA E FAMILJEVE PERFITUESE TE NE



Familjet me 2-5 anëtarë përbëjnë shumicën e përfituesve, duke reflektuar një tipologji të përhapur në Pukë.

Të dhënat e prezantuara evidentojnë nevojën për një qasje të integruar në hartimin e politikave sociale vendore, duke u fokusuar jo vetëm në ndihmën ekonomike, por edhe në shërbime të synuara që adresojnë sfidat strukturore si: izolimi gjeografik, mungesa e shërbimeve, struktura familjare me barrë të lartë sociale, dhe përqindja e lartë e të miturve. Kjo analizë do të orientojë Planin Social Vendor drejt ndërhyrjeve të diferencuara dhe gjithëpërfshirëse.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Pukë nuk ofrohen aktualisht shërbime shoqërore të posaçme për familjet në nevojë. Mbështetja për këtë kategori kufizohet në ndihmën financiare përmes Skemës së Ndihmës Ekonomike dhe fondi 6%, të cilat ndihmojnë në përballimin e nevojave bazë, por janë të pamjaftueshme për të siguruar mirëqenie të qëndrueshme, sidomos për familjet me fëmijë apo me shumë anëtarë. Këto familje kanë akses shumë të ulët në shërbime të tjera mbështetëse si strehimi, arsimi, formimi profesional apo punësimi.

Përtej skemave financiare, Bashkia Pukë, në bashkëpunim me komunitetet fetare dhe donatorë lokalë (p.sh. biznese vendase), ofron mbështetje të kufizuar dhe sporadike në formën e pakove ushqimore dhe ndihmave të ngjashme për familjet që nuk përfitojnë nga ndihma ekonomike. Kjo ndihmë, megjithëse e vlefshme për përballimin e situatave të menjëhershme, mbetet e fragmentuar dhe nuk përbën një mekanizëm të strukturuar dhe të qëndrueshëm mbështetjeje sociale.

Një element pozitiv në territor është prania e administratorëve shoqërorë në çdo njësi administrative, të cilët ofrojnë shërbime parashoqërore për qytetarët dhe familjet në nevojë. Në një bashki me territor të gjerë, të thyer dhe kryesisht malor, ky shërbim luan një rol të rëndësishëm në identifikimin e hershëm të nevojave, asistencën për plotësimin e dokumentacionit dhe orientimin drejt strukturave përgejgjëse. Administratorët shoqërorë përfaqësojnë një hallkë të rëndësishme lidhëse midis komunitetit dhe shërbimeve vendore.

Sipas të dhënave të Zyrës Vendore të Punësimit (AKPA) Pukë, nga 396 punëkërkues të papunë të regjistruar në vitin 2024, 167 janë anëtarë të familjeve përfituese nga ndihma ekonomike. Këta individë kanë përfutur shërbime këshillimi, orientimi drejt tregut të punës, ndërmjetësim për punësim si dhe përfshirje në kurse të formimit profesional. Vetëm gjatë vitit 2024, 50 persona nga këto familje kanë ndjekur trajnime profesionale të ofruara nga Qendra Lëvizëse e Formimit Profesional: 16 prej tyre ishin të rinj (të mbështetur nga strategjia rinore), 20 i përkisnin grupmoshës 30–50 vjeç dhe 14 ishin mbi 50 vjeç.

Në kuadër të strategjisë së daljes nga ndihma ekonomike, Bashkia Pukë orienton anëtarët madhorë dhe të aftë për punë të këtyre familjeve drejt shërbimeve të AKPA, për t'u përfshirë në punësim apo formim profesional. Megjithatë, kjo mbështetje mbetet e pjesshme dhe e pamjaftueshme në mungesë të një ndjekjeje individuale të rasteve dhe të programeve të qëndrueshme punësimi, të përshtatura me realitetin lokal. Në këtë drejtim, AKPA Pukë ka propozuar zbatimin e modelit austriak të formimit profesional, përmes ngritjes së një shkolle të specializuar në fusha me potencial punësimi si turizmi dhe pëpunimi, me kurrikula të përshtatura për kontekstin e Pukës. Bashkia synon të bashkëpunojë me AKPA për zbatimin e këtij modeli dhe për të forcuar ndërgjegjësimin e të rinjve mbi vlerën e arsimit profesional si rrugë konkrete drejt integritimit ekonomik.

Në përfundim, situata aktuale tregon se familjet në nevojë në Bashkinë Pukë përballen me mungesë shërbimesh të strukturuar dhe mbështetje të qëndrueshme. Për të përmirësuar përfshirjen sociale dhe ekonomike të këtij grupi, nevojitet një qasje më gjithëpërfshirëse, e mbështetur në bashkëpunim institucional, zgjerim të shërbimeve dhe orientim afatgjatë drejt fuqizimit të tyre në komunitet.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e situatës, nevojat më urgjente për këtë kategori përfshijnë:

- ✓ Krijimi i një databaze të integruar për familjet në nevojë, me të dhëna mbi përbërjen familjare, nevojat shëndetësore, arsimore dhe strehimore;
- ✓ Zgjerimi i mbështetjes përtej ndihmës ekonomike, përmes shërbimeve komunitare, kështillimit familjar dhe përfshirjes në formim profesional;
- ✓ Ngritja e një qendre multifunksionale për shërbime sociale që të veprojë si pikë kontakti dhe orientimi për familjet në nevojë;
- ✓ Ndërlidhja funksionale me shkollat, QKF-të dhe shërbimet shëndetësore për identifikimin dhe referimin e rasteve vulnerabël;
- ✓ Rritja e roli të bashkisë në mbështetje dhe këtyre familjeve nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të dhe përtititjes së fondeve shtesë.

Diagnoza eidenton se familjet në nevojë në Bashkinë Pukë përballen me sfida të ndërlukuara ekonomike, sociale dhe territoriale, të cilat kërkojnë ndërhyrje të shumëanshme dhe të koordinuara. Mungesa e shërbimeve të integruara, mbështetja e kufizuar përtej ndihmës ekonomike dhe vështirësitë në aksesimin e arsimit, punësimit dhe strehimit theksojnë domosdoshmërinë për politika sociale të orientuara drejt fuqizimit të familjes dhe përfshirjes së tyre në jetën komunitare. Kjo analizë do të shërbejë si bazë për hartimin e prioriteteve konkrete në Planin Social Vendor.

1.2 Diagnoza për Personat me AK

Diagnoza e situatës së personave me aftësi të kufizuara (PAK) në Bashkinë Pukë është një hap thelbësor drejt ndërtimit të një sistemi më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Ajo synon të eidentojë jo vetëm përmasat e këtij grupi dhe shpërndarjen e tij në territor, por edhe të analizojë me vëmendje nevojat e tyre specifike dhe shkallën e aksesit në shërbime publike. Në

fokus të kësaj diagnoze janë jo vetëm të dhënat statistikore dhe shërbimet ekzistuese, por edhe boshllëqet strukturore dhe institucionale që kufizojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta për personat me AK. Dokumenti shërben si një bazë për planifikimin e ndërhyrjeve të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së jetës për këtë kategori dhe promovimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në jetën komunitare.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore


Personat me aftësi të kufizuara (PAK) përfaqësojnë një nga kategoritë më të ndjeshme në Bashkinë Pukë, duke përfshirë individë të moshave, niveleve dhe profileve të ndryshme të kufizimeve fizike, mendore dhe shqisore. Ky grup përballlet me sfida të shumta, që nisin nga izolimi social, mungesa e aksesit në shërbime bazë, pamundësia për të ndjekur arsim të përshtatur, mungesa e punësimit të asistuar dhe pamjaftueshmëria e infrastrukturës së përshtatur për lëvizshmërinë. Vështirësitë thellohen në zonat e thella rurale, ku mungojnë strukturat mbështetëse dhe ndërgjegjësimi komunitar është i ulët.

Rreth 65% e PAK jetojnë në zonat rurale. Profili i moshës tregon se një pjesë e konsiderueshme janë në moshë pune, por përfshirja e tyre në tregun e punës është minimale. Një pjesë e konsiderueshme janë të pamartuar dhe jetojnë me familjarët, ndërkohë që ka raste me risk të lartë për vetmi. Bashkia nuk zotëron një databazë të integruar që të përmbledhë të dhëna të detajuara mbi llojin e aftësisë së kufizuar, shkallën e varësisë dhe nevojat e veçanta, çka vështirëson planifikimin e shërbimeve të personalizuar. Gjithashtu, mungojnë të dhëna mbi aksesin e PAK në arsim, punësim apo shëndetësi.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet


Sipas të dhënave të vitit 2024, në Bashkinë Pukë janë evidentuar gjithsej 549 persona me aftësi të kufizuara (PAK) që përfshijnë pagesë në cash për shkak të aftësisë së kufizuar. Shpërndarja sipas kategorive ligjore tregon se 246 prej tyre (44.8%) kategorizohen si PAK të tjerë, 239 (43.5%) si invalidë, 39 (7.1%) si të verbër dhe 25 (4.6%) si para dhe tetraplegjikë.

KATEGORITW PËRITUES TË PAGESËS PËR SHKAK TË AK



Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e përfutuesve i përket kategorive "PAK të tjerë" dhe "invalidë", të cilat përbëjnë së bashku mbi 88% të totalit. Kjo strukturë sugjeron një profil të larmishëm të aftësisë së kufizuar në komunitet, me nevoja të ndryshme që nuk mund të adresohen vetëm përmes ndihmës financiare.

Në raport me popullsinë totale të bashkisë, 3.83% e banorëve (sipas Cens 2023) përfillojnë pagesë në cash për shkak të aftësisë së kufizuar, ndërsa 40.06% e përfutuesve të Pagesës për shkak të AK jetojnë në qytet, çka tregon përqendrim të pjesëmarrjes urbane në përfutim, por edhe duke reflektuar një përqendrim më të lartë të përfutuesve në zonat urbane, ndërkohë që në zonat rurale mund të ketë persona me aftësi të kufizuara që nuk janë ende të identifikuar ose të përfshirë në skemën e mbështetjes



Kjo situatë nënvizon nevojën për ndërtimin e një databaze të detajuar funksionale për PAK në nivel vendor dhe për një vlerësim funksional gjithëpërfshirës që mund të ndihmojë në dizajnimin e ndërhyrjeve të synuara sipas tipologjisë së AK-së.

Boshllëqet aktuale, të cilat kufizojnë përfshirjen sociale të PAK në Bashkinë Pukë, përfshijnë:

- Shkallën e varësisë dhe tipin e asistencës që kërkojnë këto kategori;
- Aksesin në arsim, shërbime shëndetësore, rehabilitim, ose punësim;
- Përdorimin e ndihmave teknike, që janë elementë kyç për përfshirjen sociale.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht, mbështetja për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në Bashkinë Pukë mbështetet kryesisht në përfitimet financiare të garantuara nga legjislati në fuqi, përfshirë ndihmën ekonomike dhe pagesën për shkak të aftësisë së kufizuar. Megjithatë këto

përfitime ofrojnë një formë mbështetjeje minimale, ato nuk plotësojnë nevojat e shumta dhe të ndryshme të kësaj kategorie. Bashkia ofron një numër të kufizuar shërbimesh sociale, duke mos arritur të adresojë dimensionin rehabilitues, edukues dhe fuqizues të mbrojtjes sociale për PAK.

a) Shërbimi i Ndihmës Personal

Shërbimi i Ndihmës Personal është një ndër të vetmet forma të organizuara të mbështetjes që ofron Bashkia për personat me AK. Ky shërbim mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm, në varësi të gjendjes shëndetësore dhe nevojës së vlerësuar nga komisionet shumëdisiplinore përkatëse. Pagesa për këtë shërbim realizohet në formën e një transferte mujore në cash për kujdestarin që ofron ndihmën.

Gjatë vitit 2024, përfutes të shërbimit të Ndihmës Personal janë 143 persona me AK, kryesisht të kategorisë “PAK të tjerë” (110 raste), si dhe 25 persona para/tetraplegjikë dhe 8 të verbër.

Kategoria e AK	Numri i përfutësve PAK të Ndihmës Personal vitit 2024
Para dhe tetraplegjikë	25
Të verbër	8
Invalidë	-
PAK të tjerë	110
Total	143

b) Shërbimet arsimore

Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor përfaqëson një aspekt pozitiv në Bashkinë Pukë, megjithëse ende mbeten sfida të shumta për të garantuar vazhdimësinë dhe përfshirjen gjithëpërfshirëse në nivelet më të larta arsimore. Nga 15 fëmijë me AK të moshës shkollore, (që përbëjnë 81.25% të fëmijëve me AK) ndjekin arsimin e detyrueshëm, por vetëm 4 fëmijë të moshës 16–18 vjeç janë të regjistruar dhe ndjekin arsimin e mesëm.

Pavarësisht se legjislacioni parashikon dyfishimin dhe trefishimin e pagesës për PAK që ndjekin përkatësisht arsimin e mesëm dhe të lartë me shpërbujë nga puna, numri i PAK që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë mbetet shumë i ulët. Kjo lidhet me disa faktorë pengues: nivelet e ulëta akademike në arsimin bazë të fëmijëve me AK, mungesa e mbështetjes nga familjet, vështirësitë ekonomike, distanca e largët e shkollave nga vendbanimet, numri i ulët i mësuesve ndihmës në arsimin e mesëm, si dhe barrierat tjera të natyrës sociale dhe komunikative.

Tabele e PAK frekuentues të arsimit të mesëm dhe të lartë

Kategoria	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë
Para dhe tetraplegjikë	0	0
Të verbër	0	0
Invalidë	4	6
PAK të tjerë	4	6

Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se vetë personat me AK të kategorizuar “PAK të tjerë” ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë, respektivisht 4 dhe 6 PAK. Ndërsa personat parandhe tetraplegjik dhe personat e verbër nuk ndjekin vetëm ciklin e detyrueshem 9 vjeçar.

c) Shërbimet shoqërore

Në Bashkinë Pukë, mbështetja shoqërore për personat me aftësi të kufizuara mbetet shumë e kufizuar dhe e përqendruar kryesisht tek fëmijët me AK. Aktualisht, 39 fëmijë me aftësi të kufizuara (prej të cilëve 61% janë vajza) përfitojnë shërbime në qendrat shëndetësore

pranë njësive administrative, me mbështetjen e UNDP dhe Bashkisë Pukë. Megjithatë, vetëm 4 prej këtyre fëmijëve përfitojnë shërbime të specializuara rehabilituese, si fizioterapi dhe këshillim psikologjik, në Qendrën Komunitare pranë bashkisë.

Shërbimet për personat me AK mbi moshën 18 vjeç mungojnë plotësisht. Në territorin e bashkisë nuk ofrohen terapi mbështetëse të vazhdueshme (si terapi fizike, psikologjike, logopedike), programe rehabilitimi social apo trajnime për zhvillimin e aftësive jetësore dhe profesionale. Mungon gjithashtu edhe qasja e integruar që do të mundësonte lidhjen e këtyre shërbimeve me sistemin e kujdesit shëndetësor, arsimor dhe të punësimit.

Mungesa e këtyre shërbimeve ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në cilësinë e jetës së PAK, veçanërisht për të rriturit dhe ata që nuk përfshihen më në sistemin arsimor. Ajo thellon izolimin social, rrit varësinë nga familja dhe e bën të pamundur për shumë individë me AK ndërtimin e një jete të pavarur. Mungesa e ndërhyrjeve të hershme dhe mbështetjes afatgjatë redukton ndjeshëm mundësitë për zhvillim personal, integrim shoqëror dhe përfshirje në tregun e punës.

d) Punësimi dhe formimi profesional

Fuqizimi ekonomik dhe profesional i PAK në Bashkinë Pukë paraqet sfida të mëdha. Vetëm 1.26% e personave të papunë dhe punëkërkuar të regjistruar janë persona me aftësi të kufizuara. Mungojnë të dhënat për përfshirjen e PAK në kurset e formimit profesional, duke dëshmuar për mungesë programesh dhe ndërmjetësimi për këtë kategori. Po ashtu, nuk ekziston një program i strukturuar për orientimin drejt tregut të punës apo për nxirjen e punësimit të mbështetur.

Shërbimet për PAK në Bashkinë Pukë karakterizohen nga fragmentaritet, mbështetje të kufizuar dhe mungesë të qasjes gjithëpërfshirëse. Theksi mbetet tek përfitimet financiare dhe jo tek ofrimi i shërbimeve rehabilituese, sociale dhe edukative. Nevojitet një orientim i qartë drejt zhvillimit të shërbimeve në komunitet, krijimit të qendrave diore, zgjerimit të shërbimeve për të rriturit me AK dhe ndërtimit të mekanizmave për përfshirje aktive të tyre në vendimmarrje dhe jetë shoqërore.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e situatës dhe boshllëqeve të identifikuara, nevojat kryesore për ndërhyrje prioritare janë

- ✓ Zhvillimi i shërbimeve komunitare dhe rehabilituese për fëmijët dhe të rriturit me AK, përfshirë qendra diore, kujdes në familje, terapi fizike, psikologjike dhe logopedike.
- ✓ Nxirja e përfshirjes në arsim dhe punësim, përmes riutësimit të mësuesve ndihmës, përshfaqjes së materialeve didaktike, zhvillimit të kurseve të formimit profesional dhe promovimit të punësimit të mbështetur.
- ✓ Krijimi i një databaze funksionale dhe realizimi i vlerësimeve funksionale, për të mundësuar planifikim të bazuar në nevojat reale të PAK.
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit dhe aksesit në vendimmarrje, përmes fushatave edukative, përfshirjes së PAK në politika vendore dhe përshfaqjes së infrastrukturës publike sipas standardeve të aksesueshmërisë.

Analiza e thelluar tregon qartë se personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Pukë përballen me sfida të shumta që prekin të gjitha aspektet e jetës: arsimimin, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe përfshirjen sociale. Mbulimi i pjesës me shërbime, mungesa e strukturave rehabilituese dhe e mbështetjes për jetesë të pavarur, si dhe mungesa e të dhënave funksionale e bëjnë të pamundur përfshirjen aktuale të sistemit lokal të mbrojtjes sociale. Megjithatë, ekziston një potencial i konsiderueshëm për përmirësim përmes zhvillimit të shërbimeve komunitare, forcimit të kapaciteteve vendore dhe ndërtimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse. Adresimi i nevojave të PAK kërkon angazhim të qëndrueshëm institucional, burime të dedikuara dhe një vizion të qartë për të garantuar barazi dhe dinjitet për të gjithë qytetarët, pavarësisht aftësisë së tyre.

1.3 Diagnoza e fëmijëve në rrezik

Analiza e situatës së fëmijëve në Bashkinë Pukë tregon qartë për një mjedis me mungesë strukturash të posaçme që mbështesin zhvillimin, mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre të barabartë. Nevojat për ndërhyrje nuk burojnë vetëm nga mungesa e shërbimeve, por edhe nga boshllëqet sistematike në nivel institucional dhe komunitar, që e bëjnë të pamundur garantimin e një mbështetjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për këtë kategori.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Fëmijët përbëjnë një kategori kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Pukë, por njëkohësisht përballen me sfida të shumta që ndikojnë në mirëqenien e tyre. Pjesa më e madhe jetojnë në zona rurale, ku mungesa e infrastrukturës, e shërbimeve bazë dhe e mbështetjes institucionale i ekspozon ndaj përjashtimit social dhe edukativ.

Zhvillimi i hershëm është i kufizuar për shkak të mungesës së kujdesit parashkollor dhe mbështetjes psikosociale. Familjet me të ardhura të ulëta nuk arrijnë të përmbushin nevojat bazë të fëmijëve, duke ndikuar negativisht në ushqyerjen, edukimin dhe zhvillimin e tyre emocional.

Kategori të veçanta si fëmijët me aftësi të kufizuara, ata që jetojnë në familje në nevojë apo fëmijët që përballen me dhunë kërkojnë ndërhyrje specifike dhe të koordinuara. Mungesa e një sistemi funksional për identifikimin dhe mbrojtjen e hershme e përkeqëson më tej situatën.

Garantimi i mbrojtjes së tyre dhe krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës për çdo fëmijë mbetet një ndër sfidat më të rëndësishme për bashkinë.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat e marra nga Rregjistri Civil të viteve 2022–2024 tregojnë një rënie të përgjithshme me 4.6% të popullsisë së fëmijëve, me uljen më të ndjeshme në grupmoshën 16–18 vjeç (-9.8%). Ky trend lidhet me braktisjen e hershme të shkollës dhe mungesën e mundësive për arsim të mesëm cilësor dhe formim profesional, veçanërisht në zonat e thella.

Grafiku i shpërndarjes së fëmijëve sipas grupmoshave (0-6, 7-15, 16-18) në vitet 2022 dhe 2024.

Për sa i përket aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, 276 fëmijë (199 të grupmoshës 0-14 vjeç dhe 77 të grupmoshës 15-18 vjeç) jetojnë në familje përfutuese të ndihmës ekonomike. Bashkia Pukë nuk ofron aktualisht asnjë shërbim shoqëror të strukturuar për fëmijët dhe të rinjtë, ndërsa mungesa e të dhënave të detajuara për kategoritë në nevojë (fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë në konflikt me ligjin, viktima të dhunës, etj.) kufizon aftësinë e institucioneve për të planifikuar dhe ndërhyrë në mënyrë efektive.

Rakordimi i dobët i të dhënave midis institucioneve vendore dhe atyre të linjës sjell mospërputhje dhe boshllëqe në identifikimin e fëmijëve në situata risku. Për shembull, raportimi për rastet e dhunës ndryshon ndjeshëm midis Bashkisë, Policisë së Shtetit dhe Zyrës Vendore Arsimore.

Boshllëqet kryesore të evidentuara:

- Mungesa e të dhënave të detajuara për fëmijët sipas kategorive sociale, gjimore dhe territoriale;
- Pamjaftueshmëri e shërbimeve për zhvillimin e hershëm, të përqendruara vetëm në zonat urbane;
- Mungesa e qendrave komunitare për fëmijët jashtë sistemit shkollor;
- Mungesa e hapësirave dhe ndërhyrjeve për zhvillimin e fëmijëve të talentuar
- Mungesa e një sistemi funksional për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve në risk.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Pukë, shërbimet publike të dedikuara për fëmijët janë të pakta dhe me mbulim të kufizuar gjeografik. Ndërkohë që ofrohet arsimi në nivelet bazë dhe të mesëm, cilësia e edukimit, mbështetja individuale për fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe siguria psikosociale në shkolla mbeten sfida të vazhdueshme. Bashkia nuk ofron shërbime shoqërore të strukturuar për fëmijët – mungojnë qendrat diore, programet zhvilluese të përditshme dhe rrjetet komunitare të dedikuara për fëmijët në nevojë. Po ashtu, nuk ofrohen shërbime të specializuara për fëmijët me nevoja të veçanta apo për ata që janë viktima të dhunës, ndërsa shërbimet kulturore, sportive dhe krijuese janë thuajse të papërfshira.

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, Bashkia ka ngritur Sektorin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Qendrat Komunitare Sociale, si një strukturë përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve në këtë fushë. Brenda këtij sektori funksionon edhe specialisti i mbrojtjes së fëmijëve, me rol të rëndësishëm në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve.

Megjithatë, puna e sektorit përballët me kufizime serioze që lidhen kryesisht me mungesën e bashkëpunimit institucional dhe të një sistemi funksional për shkëmbimin dhe rakordinin e të dhënave ndërmjet institucioneve lokale. Mungesa e informacionit të unifikuar dhe e të dhënave të përditësuara për fëmijët vulnerabël pengon ndërhypjen e hershme dhe planifikimin efektiv të shërbimeve. Në këtë kontekst, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërtimi i një baze të përbashkët të të dhënave mbetet një nga nevojat më të ngutshme.

Në Bashkinë Pukë vihet re mungesa e organizatave joqeveritare (OJF) aktive që të ofrojnë ose mbështesin shërbime të dedikuara për fëmijët në nevojë. Kjo përbën një boshllëk serioz në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, duke kufizuar mundësitë për ndërhypje të hershme, përkrahje psikologjike, sociale apo edukative jashtë kuadrit institucional. Mungesa e OJF-ve reduktin potencialin për inovacion në ofrimin e shërbimeve, për bashkëpunime ndërsektoriale dhe për tërheqjen e burimeve alternative, si projektet me financim të huaj. Në këtë kontekst, krijimi i një klime nxitëse për angazhimin e organizatave jo-publike dhe forcimi i partneriteteve lokale mbetet një nevojë urgjente për të zgjeruar mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve në territorin e bashkisë.


4. Nevojat për ndërhypje prioritare

Bazuar në analizën e situatës së fëmijëve në territorin e Bashkisë Pukë, identifikohen pesë nevoja prioritare që kërkojnë ndërhypje urgjente dhe të koordinuar:

- ✓ Ngritja e shërbimeve sociale të strukturuarra për fëmijët, përfshirë qendra diore, programe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për fëmijët në situatë dhune apo risku.
- ✓ Zgjerimi i aksesit në shërbimet e edukimit të hershëm, veçanërisht në zonat rurale, përmes hapjes së qerdheve dhe kopshteve dhe përfshirjes së familjeve në nevojë.
- ✓ Krijimi i hapësirave komunitare gjithëpërfshirëse, që ofrojnë aktivitete edukative, sportive dhe krijuese pas shkollës dhe mbështesin zhvillimin e talenteve të fëmijëve.
- ✓ Fuqizimi i sistemit funksional për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbledhjes së të dhënave të detajuara për fëmijët në nevojë.

Situata e fëmijëve në Bashkinë Pukë kërkon një vëmendje të shtuar dhe gasje të integruar, që shkon përtej adresimit të nevojave bazike. Megjithatë përplekjet institucionale dhe ekzistencën e sektorit të mbrojtjes së fëmijëve, mungesa e shërbimeve të strukturuarra, koordinimi i

Fëmijë sipas vendbanimit urban/rural




Nga ana tjetër, Censi 2023 evidenton vetëm 851 fëmijë të grupmoshës 0-14 vjeç që jetojnë fizikisht në territorin e bashkisë, duke sinjalizuar ndikimin e emigracionit dhe lëvizjeve të brendshme të popullsisë në reduktimin e prezencës reale të fëmijëve.

Infrastruktura për zhvillimin e hershëm është e përgjendruar vetëm në qytet. Në Pukë funksionon një çerdhe me 32 fëmijë (15 prej tyre vajza), ku vetëm një fëmijë vjen nga një familje përfituese e ndihmës ekonomike. Po ashtu, dy kopshte publike akomodojnë 92 fëmijë (44 vajza), prej të cilëve 7 fëmijë vijnë nga familje me ndihmë ekonomike. Mungesa e çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale krijon barrierë serioze për zhvillimin e hershëm dhe përfshirjen e grave në tregun e punës.

Në nivel arsimor, në territorin e bashkisë funksionojnë 18 shkolla 9-vjeçare dhe 53 klasa kolektive, por vetëm njëra nga shkollat ndodhet në qytet. Arsimin bazë e ndjekin 538 fëmijë, ndërsa në arsimin e mesëm janë të regjistruar vetëm 182 nxënës të shpërndarë në 4 shkolla (një në qytet), çka tregon për vështirësitë që lidhen me vijimësinë arsimore.

Pavarësisht identifikimit të 70 fëmijëve të talentuar nga Zyra Vendore Arsimore (10 në moshën 0-6 vjeç, 40 në 7-14 vjeç dhe 20 në 16-18 vjeç), mungojnë hapësirat dhe programet për zhvillimin e talenteve, duke lënë potencialin e tyre të pashfrytëzuar.



Tregon tendencën e uljes së popullsisë së fëmijëve dhe dallimet sipas grupmoshave

Sipas Regjistrit Civil 2024, në territorin e Bashkisë Pukë jetojnë 3,160 fëmijë të moshës 0-18 vjeç, nga të cilët rreth 67% (2,129 fëmijë) ndodhen në zona rurale. Kjo shpërndarje territoriale nënvizon nevojën për një shpërndarje më të barabartë të shërbimeve bazë për fëmijët jashtë zonës urbane.

Grafiku i shpërndarjes së fëmijëve sipas zonave (rurale vs urbane)

dobët ndërinstitucional dhe mungesa e të dhënave të harmonizuara e kufizojnë ndikimin real në jetën e fëmijëve në nevojë. Kjo diagnozë nënvizon domosdoshmërinë e ndërtimit të një sistemi lokal gjithëpërfshirës dhe funksional për mbrojtjen e fëmijëve, që kombinon parandalimin, ndërhyrjen e hershme dhe ofrimin e shërbimeve afatgjata. Në këtë kuptim, Bashkia Pukë ka mundësinë të riorientojë politikatat lokale drejt investimeve konkrete për mirëqenien e fëmijëve, duke vendosur fëmijët në qendër të zhvillimit social dhe të ardhmes së komunitet

1.4 Diagnoza për viktimat e dhunës dhe trafikimit

Dhuna në familje përbën një sfidë të rëndësishme për politikën sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel vendor. Në Bashkinë Pukë, ndonëse raportimi i rasteve është ende i ulët, problematika e dhunës mbetet prezente dhe kërkon vëmendje të situatuar institucionale dhe ndërsektoriale. Diagnostikimi i situatës së viktimave të dhunës synon të identifikojë tiparet kryesore të fenomenit, boshllëqet në informacion dhe shërbime, si dhe nevojat për ndërhyrje konkrete në mbrojtje të grave, vajzave dhe fëmijëve të prekur.

1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Viktimat e dhunës përbëjnë një kategori në rritje në Bashkinë Pukë, që përfshin kryesisht gra dhe fëmijë, të cilët përballen me një sërë sfidash sociale, ekonomike dhe institucionale. Dhuna në familje vijon të mbetet një problem i nënraportuar dhe i vështirë për t'u adresuar në një territor ku mungojnë strukturat e specializuara për trajtimin dhe mbështetjen e viktimave. Gratë dhe fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës shpesh përballen me papunësi, varfëri, izolim social dhe mungesë të qasjes në mbrojtje të menjëhershme. Kjo situatë rëndohet më tej nga mungesa e një strehëze emergjente dhe e shërbimeve të integruara për rehabilitimin dhe fuqizimin e viktimave.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat për periudhën 2022-2024 tregojnë një rritje të ndjeshme të rasteve të raportuara të dhunës në Bashkinë Pukë. Në vitin 2022 dhe 2023 janë referuar nga 2 raste çdo vit, ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar 8 raste. Ky numër tregon ose rritje dhe përkeqësim të situatës reale, ose përmirësim të mekanizmit të identifikimit dhe raportimit të dhunës, ose rritje të vetëdijes së komunitetit për denoncimin e rasteve. Bashkia nuk ofron të dhëna që ndihmojnë në kuptimin e shkakut të këtij katërfishimi të rasteve të dhunës.

Sipas gjinisë dhe moshës, në vitin 2024 raportohen gjithsej 4 raste të grave dhe vajzave, si dhe 4 raste të fëmijëve. Nuk janë evidentuar raste të burrave apo të moshuarve. Midis viktimave mbi 18 vjeç (4 raste), të gjitha janë njëkohësisht të papuna dhe përfutuese të ndihmës

ekonomike, çka tregon një lidhje të drejtpërdrejtë mes dhunës dhe varfërisë apo nivelit të ulët ekonomik. Asnjë prej viktimave të identifikuarra nuk rezultoi të jetë e pastrehe.

Një nga kufizimet kryesore të këtyre të dhënave është mungesa e saktësisimit të mbulimit gjeografik (nuk përcaktohet nëse rastet e raportuara i përkasin vetëm njësisë administrative Pukë apo të gjithë territorit të Bashkisë). Kjo paqartësi e vështirëson vlerësimin real të përhapjes së dhunës dhe planifikimin e ndërhyrjeve në nivel vendor.

Megjithatë Bashkia Pukë ka të emëruar një koordinator për rastet e dhunës në familje, të dhënat mbi fenomenin mbeten të fragmentuara dhe të pamjaftueshme për të ndërtuar një kuadër të qartë të situatës. Mungon një databazë e unifikuar dhe e përditësuar për rastet e dhunës, ndërsa raportimi nuk përfshin qartësisht të gjitha njësitë administrative, gjë që sugjeron nevojën për forcimin e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit në mënyrë të standardizuar. Kjo tregon për kufizime në funksionimin e plotë të rolit të koordinatorit në praktikë dhe vështirësi në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe reagimi institucional.

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Pukë nuk funksionon një strukturë e specializuar si Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës apo një strehë emergjente për rastet e dhunës në familje. Megjithatë, në zbatim të kuadrit ligjor, bashkia ka të emëruar një Koordinator për masat kundër dhunës në familje dhe për barazinë gjinore, i cili është përgjegjës për ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve në nivel vendor. Në funksion të këtij roli, koordinatori mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial, në përbërje të të cilit bëjnë pjesë edhe administratorët shoqërorë të njësisë administrative.

Pavarësisht këtij mekanizmi të ngritur, menaxhimi efektiv i rasteve në praktikë has vështirësi për shkak të mungesës së organizatave joqeveritare dhe të shërbimeve të specializuara për këtë kategori. Kjo e bën të kufizuar mbështetjen që mund të ofrohet për viktimat, sidomos në aspekte si rehabilitimi psikologjik, ndihma ligjore apo strehimi emergjent.

Përmes Qendrës Komunitare, bashkia ofron disa forma mbështetjeje për gra dhe vajza në situatë vulnerabel, duke përfshirë këshillim psikologjik, mbështetje ushqimore dhe ndërmjetësim për punësim. Gjatë vitit, 8 viktima të dhunës kanë përfutur shërbime në këtë qendër, duke përfshirë mbështetje psikosociale dhe orientim drejt mundësive të integritimit. Ky angazhim përbën një hap pozitiv, por mbështetja mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së shërbimeve të specializuara dhe të rrejtit të organizatave që mund të garantojnë mbrojtje dhe rehabilitim të plotë për këtë kategori.

Gjatë takimeve me komunitetin dhe nëpërmjet grupeve fokale, u evidentua se shumë raste dhune nuk raportohen nga viktimat për shkak të frikës, mungesës së besimit ose pamundësisë për të kërkuar ndihmë. Në këtë kontekst, ekzistenca e një NJVRN aktive dhe organizimi i fushatave të mirëstrukturuarat ndërgjegjëse do të ndihmonin në rritjen e raportimit dhe qasjes së viktimave ndaj shërbimeve mbështetëse.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Për të përmirësuar mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në Bashkinë Pukë, nevojiten një sërë ndërhyrjesh të koordinuara dhe të përshatura me kontekstin lokal:

- ✓ Ofrimi i shërbimeve të integruara për viktimat e dhunës, përfshirë këshillim psikosocial, ndihmë ligjore, mbështetje për integrim dhe ndërmjetësim për strehim emergjent.
- ✓ Forcimi i rolit të Koordinatorit Vendor dhe Grupit Teknik Ndërsektorial, përmes trajnimeve, mbështetjes logjistike dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional për menaxhimin efektiv të rasteve.
- ✓ Zhvillimi i fushatave të rregullta ndërgjegjëse në komunitet, sidomos në zonat rurale, për të nxitur raportimin e rasteve dhe për të promovuar barazinë gjinore dhe mbrojtjen e viktimave.
- ✓ Përmirësimi i përdorimit të sistemit ekzistues të raportimit dhe dokumentimit të rasteve, me synim përfshirjen e të gjitha njësisve administrative dhe ndarjen e standardizuar të informacionit ndërmjet institucioneve.
- ✓ Nxiti e partnerieteve me organizata të shoqërisë civile, për të ofruar shërbime të specializuara dhe për të rritur mbështetjen për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave.

Analiza tregon se mbështetja për viktimat e dhunës në Bashkinë Pukë është ende e fragmentuar dhe e kufizuar, duke reflektuar boshllëqe në shërbime, koordinim dhe akses në informacion. Rritja e rasteve të raportuara në vitin 2024 përbën një sinjal alarmi, por njëkohësisht një mundësi për të forcuar mekanizmat institucionale dhe për të zgjeruar qasjen ndaj shërbimeve të integruara. Zhvillimi i një qasjeje të koordinuar ndërinstitucionale, bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe fuqizimi i strukturave ekzistuese do të jenë çelësi për garantimin e mbrojtjes efektive dhe rehabilitimit të qëndrueshëm të viktimave të dhunës në këtë territor.

1.5 Diagnoza për të Moshuarit në Nevojë – Bashkia Pukë

Popullsia e moshuar përbën një ndër grupet më të ndjeshme ndaj ndryshimeve demografike, sociale dhe ekonomike, duke qenë shpesh në rrezik të përjashtimit dhe izolimit. Në kontekstin e zhvillimit të politikave të mbrojtjes sociale, analiza e situatës së të moshuarve në nivel vendor është thelbësore për të kuptuar jo vetëm përmasat e plakjes, por edhe nevojat specifike për shërbime që sigurojnë dinjitet, përfshirje dhe mirëqenie për këtë kategori në rritje.


1. Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Të moshuari përbëjnë një ndër grupet më të cënueshme dhe në rritje të popullsisë në Bashkinë Pukë. Një pjesë e konsiderueshme e tyre jetojnë në kushte të vështira ekonomike, sociale dhe shëndetësore, shpesh të vetmuar, të sëmurë ose pa përkrahje familjare. Struktura gjeografike e bashkisë me zonë të thellë rurale e përkeqëson më tej aksesin në shërbime dhe ndihmë të organizuar. Ndër sfidat më të theksuara janë mungesa e përkujdesjes në familje për të moshuarit e vetmuar, mungesa e shërbimeve ditore dhe rezidenciale, mungesa e mbështetjes për të sëmurët kronikë, si dhe për ata që përfitojnë ndihmë ekonomike por jetojnë pa mbështetje të afërme.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat mbi popullsinë e Bashkisë Pukë tregojnë për një strukturë të plakur, me një përqindje të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç, sidomos në raport me popullsinë aktive dhe atë fëmijërore. Sipas Censurit 2023, në Bashkinë Pukë jetojnë 1,247 persona mbi 65 vjeç, që përbëjnë rreth 20% të totalit prej 6,222 banorësh. Megjithatë, Regjistri i Gjendjes Civile 2024 raporton një shifër më të lartë – 1,692 të moshuar nga një total prej 14,352 banorësh (shih Fig. 1)


Fig 1 Struktura demografike: Cens 2023 vs Regjistri Civil 2024



Në aspektin e dinamikës kohore, të dhënat e Regjistrit Civil tregojnë një rënie të lehtë të numrit të të moshuarve nga viti 2022 (1,745 persona) në vitin 2024 (1,692 persona), ndërkohë që popullsia e përgjithshme gjithashtu ka pësuar një rënie. Kjo sugjeron një tendencë të vazhdueshme të migrimit dhe tkurjes natyrore të popullsisë, por struktura e plakur mbetet sfidë madhore.


Në shpërndarjen sipas njësive administrative, numri më i madh i të moshuarve gjendet në qytetin e Pukës (963 persona), i ndjekur nga Gjegjani (388) dhe Qerreti (165), ndërsa njësi të si Rrapa dhe Qelëza kanë përqendrime më të ulëta. Ky konfigurim gjeografik kërkon planifikim të ndarë dhe ndërhyrje të fokusuara sipas nevojave të lokalizuara (shih Fig. 2)

Fig 2 Përqendrimi i popullsisë së moshuar (65+) në Bashkinë Pukë




Sipas të dhënave të mbledhura nga njësitë administrative, janë evidentuar gjithsej 365 të moshuar në nevojë. Prej tyre: 132 janë të vetmuar (78 gra dhe 54 burra); 105 janë të varfër; 83 vuajnë nga sëmundje kronike; 27 janë persona me aftësi të kufizuara; dhe 17 jetojnë vetëm duke përfutur ndihmë ekonomike. Kjo strukturë e detajuar ndihmon në identifikimin e kategorive prioritare për ndërhyrje sociale (shih Fig. 3)

Fig 3 Profilizimi i nevojave të të moshuarve për ndërhyrje sociale



Nga këta, 118 kanë shprehur nevojën për shërbime shoqërore, ku 61 raste kanë kërkuar përkujdesje në familje, 55 raste qendër ditore dhe 2 raste shërbim rezidencial, siç paraqitet në Fig. 4.


Fig 4 Llojet e shërbimeve shoqërore të kërkuara nga të moshuarit në Bashkinë Pukë



Njësitë me numrin më të lartë të të moshuarve në nevojë janë Qerreti dhe Puka, të cilat së bashku përbëjnë mbi 80% të rasteve. Në Qerret, numri i të moshuarve në nevojë është i barabartë me numrin total të të moshuarve, çka tregon ose një situatë të rënduar sociale, ose një proces jo të saktë identifikimi. Kjo lidhet me mungesat e një punonjësi të specializuar për moshën e tretë dhe të NJVRRN në nivel bashkië, që do të mundësonin një evidencim më të drejtë dhe të qëndrueshëm të nevojave (shih Fig. 5).

Fig 5 Shpërndarja e të Moshuarve në Nevojë krahasuar me Popullsinë 65+ sipas Njësi Administrative në Bashkinë Pukë

Të moshuar në nevojë sipas Njësive Administrative



Megjithëse kjo pasqyron realitetin e përqendrimit të popullsisë, ajo gjithashtu nënvizon nevojën për ndërtimin e shërbimeve të decentralizuara dhe përmirësimin e aksesit në të gjitha zonat.

Mungesa e të dhënave të detajuara mbi statusin shëndetësor, situatën ekonomike dhe lidhjet familjare të të moshuarve përbën një boshllëk serioz për hartimin e politikave të kujdesit social. Bashkia ka nevojë për ndërtimin e një databaze të integruar për të moshuarit në nevojë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të garantuar ndërhyrje të koordinuara dhe efektive në mbështetje të kësaj kategorie në rritje.

Këto të dhëna dhe boshllëqe theksojnë domosdoshmërinë e ngritjes së një sistemi të integruar shërbimesh dhe mekanizmash vlerësimi për të garantuar mbështetje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të moshuarit në Bashkinë Pukë

3. Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Bashkia Pukë përballlet me mungesën e një sistemi të mirëorganizuar të shërbimeve shoqërore për të moshuarit. Aktualisht mungojnë shërbimet në familje, qendrat ditore në territor dhe strukturat rezidenciale, ndonëse kërkesat për këto forma përkujdesjeje janë të pranishme dhe të dokumentuara në të gjitha njësitë administrative. Po ashtu, nuk ekziston një mekanizëm funksional për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve në nevojë, ndërkohë që mungesa e specialistëve dhe infrastrukturës e kufizon ndjeshëm ndërhyrjen institucionale. Bashkia nuk disponon një databazë të përditësuar për të moshuarit në nevojë dhe nuk ka zhvilluar mekanizma të qëndrueshëm bashkëpunimi me sistemin shëndetësor, organizatat joqeveritare apo aktorë të tjerë lokalë, çka e bën të pamundur ofrimin e mbështetjes së koordinuar. Kjo situatë i lë më të ekspozuar dhe të pambrojtur të moshuarit në rrezik, sidomos ata që janë të vetmuar, të sëmurë apo në kushte të thella varfërie.

Megjithatë, një përpjekje pozitive është realizuar përmes ndërtimit të një qendre ditore për të moshuarit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo qendër, e cila funksionon prej vitit 2023, ofron shërbime të kufizuara si aktivitete sociale, mbështetje psikologjike, ndihmë shëndetësore dhe një vakt dior për rreth 30 të moshuar (70% prej tyre gra). Ky është një hap i parë drejt përfshirjes sociale të të moshuarve, por mbulimi mbetet i pjesshëm dhe nuk i përgjigjet nevojave në rritje të kësaj kategorie në të gjithë territorin e bashkisë.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Krijimi i një baze të dhënash të përditësuar për të moshuarit në nevojë, të shpërndarë sipas tipologjive (vetmi, varfëri, sëmundje, paafësi).
- ✓ Ngritja e një shërbimi të përkujdesjes në familje, me staf të trajnuar dhe mbulim fillestar në njësitë me përqendrimin më të madh të nevojës Qerret dhe Pukë).
- ✓ Krijimi i një qendre ditore për të moshuarit në qytetin e Pukës, si pilot për përfshirje sociale, kujdes shëndetësor bazik dhe aktivitete sociale.
- ✓ Trajnimi i stafit vendor dhe ngritja e strukturave për menaxhimin e rasteve, për të garantuar ndërhyrje të koordinuar.
- ✓ Nxitja e bashkëpunimit me OJF-të dhe shëndetësinë për të siguruar mbështetje psikosociale, asistencë mjekësore dhe mbështetje komunitare për të moshuarit më të brishtë.

Diagnoza tregon qartë se të moshuari në Bashkinë Pukë përballen me sfida të shumanshme, që lidhen jo vetëm me gjendjen sociale dhe shëndetësore, por edhe me mungesën e shërbimeve të specializuara dhe mekanizmave për vlerësim të integruar të nevojave. Përballë një strukture të plakur të popullsisë dhe boshllëqeve institucionale, Bashkia ka nevojë për ndërtimin e një qasjeje të qëndrueshme dhe të decentralizuar për kujdesin ndaj të moshuarve, në mënyrë që të garantohet një mbështetje efektive, e barabartë dhe gjithëpërfshirëse për këtë grup.

1.6 Diagnoza për individë përdorues të alkoolit

Varësia ndaj alkoolit përfaqëson një shqetësim social në rritje, veçanërisht në zonat rurale dhe në mesin e meshkujve të moshës së mesme dhe të tretë, por aktualisht nuk ka të dhëna të sistematizuara mbi përmasat e fenomenit në Bashkinë Pukë. Mungesa e shërbimeve të specializuara për trajtim, këshillim apo ndërhyrje në komunitet e lë këtë kategori pa mbështetje institucionale. Staf i aktual i shërbimeve sociale nuk ka kapacitete të dedikuara për të adresuar varësinë ndaj alkoolit si një çështje shëndetësore dhe sociale njëkohësisht. Kjo kërkon një ndryshim gradual të qasjes ndaj kësaj problematike, përmes ndërthurjes së mbështetjes komunitare me ndërhyrje të strukturuar në planin vendor.

1.7 Diagnoza për individë përdorues të drogës

Bashkia Pukë nuk disponon të dhëna të detajuara mbi numrin apo karakteristikat e personave që përdorin substanca narkotike në territor. Mungesa e identifikimit dhe mosfunksionimi i një sistemi referimi e bëjnë këtë kategori të padukshme në planifikimin lokal. Aktualisht, nuk ekziston asnjë shërbim rehabilitimi apo mbështetjeje psikosociale për përdoruesit e drogave, dhe bashkia nuk ka staf të specializuar për menaxhimin e rasteve të varësisë. Kjo krijon një boshllëk të thellë në ndërhyrjet parandaluese dhe rehabilituese për të rinjtë dhe të rriturit në risk. Ngrija e NJRVN dhe përfshirja e kësaj kategorie në planifikim përfaqësojnë një mundësi për të adresuar nevoja të pazëshme, por me impakt të lartë social.

1.8 Diagnoza për individë LGBTQ+

Bashkia Pukë nuk disponon të dhëna për numrin, situatën apo nevojat e personave LGBTQ+ në komunitet. Kjo kategori mbetet e padukshme në politikat vendore dhe nuk ka pasur ndonjë ndërhyrje të dedikuar për përfshirjen e tyre sociale, mbrojtjen nga diskriminimi

apo aksesin në shërbime. Mungojnë plotësisht mekanizma raportimi dhe asnjë pjesëtar i staftit të shërbimeve sociale nuk është i trajnuar për gëshitje të diversitetit gjinor apo orientimit seksual. Për ta, përfshirja në planin social nuk është vetëm një nevojë, por një angazhim institucional që promovon barazinë dhe respekton të drejtat e çdo individi, pavarësisht identitetit apo orientimit të tij.

Përmbledhje e diagnozës sociale së familjeve dhe individëve në nevojë

Analiza e situatës sociale në Bashkinë Pukë evidenton një kontekst kompleks me sfida të theksuara demografike, gjeografike dhe institucionale që ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin dhe cilësinë e mbrojtjes sociale për grupet në nevojë. Plakja e popullsisë, largimi i të rinjve dhe përqendrimi i një pjese të madhe të banorëve në zona të thella rurale kufizojnë ndjeshëm mundësinë për përfshirje sociale, veçanërisht për familjet në nevojë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe viktimat e dhunës.

Mungesa e shërbimeve të strukturuar dhe të shpërndara në territor është një faktor përcaktues në përfshirimin e grupeve vulnerabël nga mbështetja efektive. Për më tepër, bashkia nuk disponon të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar dhe adresuar nevojat e kategorive të përfshiuara, si përdoruesit e substancave narkotike, personat në situatë varësie nga alkooli dhe personat LGBTIQ+. Këto grupe mbeten të padukshme dhe të papërfqësuar në politikat sociale, duke reflektuar mungesën e specialistëve të përkushtuar, shërbimeve të posaçme dhe mekanizmave gjithëpërfshirës në nivel vendor.

Përballë kësaj panorame, është e nevojshme një qasje e re dhe më gjithëpërfshirëse në hartimin dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes sociale në Pukë. Kjo nënkupton ngritjen e një rrethi shërbimesh të integruara dhe të aksesueshme për të gjitha grupet në nevojë, të mbështetura nga struktura funksionale, personel i kualifikuar, sisteme të qëndrueshme referimi dhe databaza funksionale. Përfshirja e kategorive më të rrezikuara në planifikim, si dhe krijimi i mekanizmave bashkëpunues ndërinstitucionalë, përfaqëson një domosdoshmëri për ndërtimin e një sistemi të barabartë dhe efektiv të mbrojtjes sociale në Bashkinë Pukë.

2. Diagnoza e shërbimeve shoqërore

Diagnoza e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Pukë ofron një pasqyrë të qartë të gjendjes aktuale të ofrimit të mbështetjes për grupet në nevojë. Ajo evidenton kapacitetet ekzistuese, boshllëqet në mbulim dhe cilësi, si dhe mungesat në strukturë, shërbime dhe të dhëna. Analiza synon të ndihmojë në planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme për të ndërtuar një sistem shërbimesh më të integruar, të përhapur në të gjithë territorin dhe të përshatur me nevojat specifike të kategorive vulnerabël

1. Përshkrimi i shërbimeve ekzistuese dhe mbulimi

Në Bashkinë Pukë, oferta e shërbimeve shoqërore është ende në një fazë të kufizuar zhvillimi, e karakterizuar nga fragmentariteti institucional dhe përqendrimi gjeografik i ndërhyrjeve. Aktualisht, mbështetja për grupet vulnerabel është përqendruar kryesisht në qytet dhe përbëhet nga dy struktura kryesore: Qendra Ditore për të Moshuarit dhe Qendra Komunitare. Këto qendra ofrojnë një gamë të kufizuar aktivitetesh për një numër të vogël përfutuesish dhe nuk arrijnë të mbulojnë nevojat e komunitetit në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Rrjeti i administratorëve shoqërorë, të pranishëm në çdo njësi administrative, luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve parashoqërore dhe shpeshherë përfaqëson hallkën e vetme të identifikimit dhe mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë. Megjithatë, mungesa e shërbimeve të strukturuar dhe të specializuara në nivel vendor mbetet problematike. Bashkia nuk ofron aktualisht asnjë formë shërbimi të drejtpërdrejtë për fëmijët në situatë rreziku, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç, viktimat e dhunës në familje, personat në varësi nga substancat narkotike apo alkooli, dhe komunitetën LGBTQ+.


Këto boshllëqe theksohen më tej nga mungesa e shërbimeve lëvizëse, qendrave ditore për kategori të tjera, programeve të ndërhyrjes së hershme dhe mekanizmeve të koordinuar ndërinstitutional. Në tërësi, mbulimi i shërbimeve është i pamjaftueshëm si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor, duke e lënë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë jashtë sistemit të mbrojtjes sociale. Kjo situatë kërkon ndërhyrje strategjike për zgjerimin, diversifikimin dhe decentralizimin e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Bashkia Pukë nuk disponon një sistem të strukturuar dhe funksional për menaxhimin e të dhënave mbi kategori të nevojë. Informacionet aktualisht të disponueshme janë të pjesshme dhe të fokusuara kryesisht tek përfutuesit e skemave të detyrueshme ligjore, si personat me aftësi të kufizuara (PAK), viktimat e dhunës dhe familjet që marrin ndihmë ekonomike. Të dhënat për të moshuarit në nevojë janë mbledhur vetëm gjatë procesit të hartimit të këtij plani për vitin 2024, ndërsa mungojnë plotësisht për periudhat e mëparshme. Për kategori të tjera si përdoruesit e substancave narkotike, alkoolit apo personat LGBTQ+, të dhënat mungojnë krejtësisht. Ndërkohë, Bashkia zotëron informacion të vazhdueshëm vetëm për kategori të që përftojnë pagesa ose shërbime të strukturuar, ndërsa mungojnë të dhënat për individët dhe familjet në nevojë që nuk përftojnë nga skemat ekzistuese të mbështetjes. Kjo situatë krijon boshllëqe serioze në planifikim, pengon ndërtimin e politikave të bazuara në evidencë dhe kufizon mundësinë për ndërhyrje të hershme dhe efektive.

Shërbimet sociale që ofron Bashkia Pukë janë të kufizuara dhe nuk arrijnë të mbulojnë të gjitha nevojat e grupeve në vështirësi. Ato janë të përgjendruara vetëm në qytet dhe nuk ofrohen në njësitë administrative të tjera. Aktualisht funksionojnë vetëm dy qendra: Qendra Ditore për të Moshuarit dhe Qendra Komunitare, të cilat zhvillojnë aktivitete të përgjithshme sociale dhe argëtuese. Megjithatë, këto qendra nuk janë të përshtatura për t'u dhënë mbështetje të veçantë grupeve që kanë nevoja specifike. Përgjendrimi i përfutuesve vetëm në disa kategori pasqyrohet edhe në fig më poshtë, ku shihet qartë shpërndarja e kufizuar e mbështetjes aktuale

Fig 1 Shpërndarja përqindore e përfutuesve aktuale sipas kategorive



Mungojë shetbime ditore apo struktura të dedikuara për fëmijët në nevojë, për personat me aftësi të kufizuar mbi 18 vjeç, për familjet me probleme të thella sociale, për viktimat e dhunës në familje apo për individët në varësi nga droga dhe alkooli. Po ashtu, mungojnë shërbime, të kujdesit në familje, programe rehabilitimi, terapi fizike dhe psikologjike, ose shërbime për integrimin shoqëror e profesional të grupeve në rrezik. Komuniteti LGBTQ+ mbetet i papërfshirë në çdo formë të adresimit institucional apo ofrimit të ndonjë shërbimi mbështetës.

Një tjetër boshllëk i madh është mungesa e shërbimeve të lëvizshme, të cilat do të mundësonin ofrimin e kujdesit dhe ndërhyrjeve sociale në zonat e thella rurale të bashkisë. Në mungesë të këtyre shërbimeve, shumë individë dhe familje mbeten jashtë mbrojtjes sociale funksionale.

Përveç mungesës së strukturave publike, nuk ka as prani aktive të organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale në territorin e bashkisë. Kjo situatë pengon ndërtimin e një modeli shërbimesh të integruara dhe të bashkërenduara, duke thelluar më tej fragmentaritetin dhe mungesën e aksesit për grupet më të rrezikuara. Për të ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës, Bashkia Pukë ka nevojë për zgjerim të formave të shërbimeve ekzistuese, përhapjen e tyre në territor dhe krijimin e partneriteteve funksionale për mbështetjen e kategorive në nevojë.

Tabela: Kapacitetet e Shërbimeve Shogërore në Bashkinë Pukë

Kategoria në nevojë	Nr. i familjeve/i ndividëve (vlerësuar në nevojë)	Nr. që përfitojnë shërbime	Llojet e shërbimeve të ofruara	Nevojat shërbime	për
Fëmijë në situatë rreziku	284	0	Marrin mbështetje bazike nga administratori shogëror (pa shërbime të strukturuar)	Shërbime shërbime komunitare, mbrojtje në të gjitha njësitë	ditore,
Persona me aftësi të kufizuar (PAK)	549	43	Marrin mbështetje bazike nga administratori shogëror (pa shërbime të strukturuar)	Shërbime interhuara ditore, rehabilituese, punësim, kujdes në familje	të
			Shërbime fizioterapi dhe këshillim psikologjik		


Të moshuar në nevojë	365	40	Marrin mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar)	Shërbime në familje, Shërbime lëvizëse Shërbime ditore
Familje ndihmë ekonomike	306	0	Qendër ditore (vetëm në gytet) Marrin mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar)	Shërbimë të integruara ditore, Shërbime lëvizëse Mbështetje psikosociale, ndihmë materiale
Viktima të dhunës në familje	8	8	Marrin vetëm mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar) Këshillim	Strehim emergjent, këshillim, mbrojtje ligjore Shërbime të integruara ditore, Shërbime lëvizëse
Përdorues të substancave narkotike	0	0	Marrin vetëm mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar)	Mbështetje psikosociale, ndihmë materiale

Përdorues të alkoolit	0	0	Marrin mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar)shërbime parashoqëror	Program ndërhyrjeje, mbështetje sociale
Personat LGBTQ+	0	0	Marrin mbështetje bazike nga administratori shoqëror (pa shërbime të strukturuar)	Shërbime mbështetëse, qasje gjithëpërfshirëse

Fig më poshtë paraqet qartë diferencën ndërmjet numrit të individëve në nevojë dhe atyre që marrin aktualisht shërbime për secilën kategori, duke evidentuar hendekun ekzistues në mbulim

Fig 1 Shpërndarja përqindore e përfituesve aktualë sipas kategorive

PËRFITOJNË SHËRBIME SHOQËRORE



4. Nevojat prioritare për ndërhyrje

- ✓ Krijimi i një sistemi funksional për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave për kategoritë në nevojë.
 - ✓ Zgjerimi i shërbimeve në territor përmes qendrave ditore dhe shërbimeve në familje për të moshuarit dhe PAK mbi 18 vjeç.
 - ✓ Fuqizimi i staftit ekzistues dhe angazhimi i specialistëve të dedikuar për kategori specifike si përdoruesit e drogave, alkoolit dhe personat LGBTQ+.
 - ✓ Krijimi i partneriteteve me OJF-të dhe aktorë të tjerë për të ofruar shërbime të integruara.
- Krijimi i një qasjeje të koordinuar ndërinstitutionale për menaxhimin e rasteve, veçanërisht për viktimat e dhunës.

Gjetjet tregojnë qartë se sistemi aktual i shërbimeve shoqërore në Bashkinë Pulë është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e grupeve më të cënueshme. Përqendrimi i shërbimeve vetëm në qytet, mungesa e shërbimeve të specializuara dhe e të dhënave të plota, si dhe mungesa e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, kanë krijuar një boshllëk të theksuar në akses dhe cilësi. Kjo situatë kërkon

një transformim të thellë dhe të qëndrueshëm, përmes zgjerimit të mbulimit territorial, ndërtimit të shërbimeve të reja dhe forcimit të mekanizmave të bashkërendimit institucional.

3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Pukë

Burimet njerëzore janë një faktor kyç për zbatimin efektiv të shërbimeve sociale në nivel vendor. Përmes strukturave të specializuara, ato garantojnë qasje të barabartë dhe reagim profesional ndaj nevojave të grupeve vulnerabël në komunitet. Diagnoza e kapaciteteve njerëzore në Bashkinë Pukë synon të vlerësojë funksionalitetin real të strukturave të ngritura, përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe sfidat që lidhen me plotësimin e roleve kyçe për menaxhimin e rasteve dhe zhvillimin e shërbimeve sociale.

1. Përshkrimi i strukturës aktuale dhe funksionit

Struktura organizative e Bashkisë Pukë për ofrimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale është e formalizuar përmes ngritjes së Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit Social, e cila përfshin disa sektorë të specializuar dhe funksione të ndara. Kjo drejtori është përgjegjëse për menaxhimin e skemave të ndihmës ekonomike dhe të paftësisë, për identifikimin dhe mbështetjen e grupeve në nevojë, hartimin e planit social vendor dhe zhvillimin e bashkëpunimeve institucionale në nivel lokal.

Sipas të dhënave të vitit 2024, struktura e burimeve njerëzore të planifikuar dhe e zënë faktikisht paraqitet si më poshtë:

Drejtoria	Sektori	Pozicioni	Nr burimeve njerëzore	
			Plan	Fakt
			përgjegjës	1
Drejtoria e Ndihmes Ekonomike, PAK dhe Shërbimit Social	Ndihmës Ekonomike dhe PAK	specialistë	5	5
		Përgjegjës	1	0
		Sherbimit Social		

Sektori i Njësise se Mbrojtjes Femijëve dhe Qendrave Komunitare Sociale	Specialist	2	0
	Pergjegjes	1	0
	Specialist	2	1

Strukturat e NJMF dhe PMF janë të ngritura dhe funksionale, ashtu si edhe pozicioni i Koordinatorit për dhunën në familje dhe barazinë gjinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bashkia Pukë nuk ka ngritur ende Njësine për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shogëror (NJVRN), ndonëse kjo është një detyrim ligjor i përcaktuar në Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shogëror", i ndryshuar.

Analiza krahasuese midis strukturës dhe funksioneve të përcaktuara në rregulloren e brendshme tregon se sektori i Shërbimit Social, që mbulon planifikimin, mbikëqyrjen, analizën e nevojave dhe monitorimin e shërbimeve sociale, është tërësisht jashtë funksionit për shkak të mungesës së stafit. Po ashtu, sektori për NJMF dhe Qendrat Komunitare, i cili duhet të drejtojë dhe koordinojë punën në nivel njësie administrative, është vetëm pjesërisht funksional me 1 specialist të zënë nga 3 të planifikuar.

Në praktikë, specialistët e Ndhmës Ekonomike dhe PAK që janë të vendosur në njësitë administrative (emërtimi sipas ligjit administratore shogërore) ushtrojnë funksione që tejkalojnë rolin e tyre primar, duke përfshirë edhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje dhe ofrimin e mbështetjes për viktimat, në mungesë të NJVRN. Këto funksione shtesë nuk janë të deleguara zyrtarisht dhe nuk shogërohen me trajnime, mbështetje teknike apo supervizim të specializuar, duke krijuar një boshllëk serioz institucional në trajtimin e rasteve sensitive.

Mungesa e zbatimit të plotë të strukturës së parashikuar në rregullore, veçanërisht në drejtim të burimeve njerëzore për shërbimet sociale të strukturuar, përbën një pengesë për zhvillimin e një sistemi të integruar të kujdesit shogëror dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Bashkisë.

2. Boshllëqet dhe sfidat në kapacitetet njerëzore

Analiza e të dhënave strukturore dhe funksionale tregon se boshllëqet në burimet njerëzore përbëjnë një pengesë serioze për funksionimin efektiv të sistemit të mbrojtjes dhe shërbimeve sociale në Bashkinë Pukë. Megjithatë është ngritur forma organizative përmes Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, PAK dhe Shërbimit Social, mungesa e personelit të dedikuar në sektorët kyç e bën të pamundur zbatimin e funksioneve bazë që parashikohen në rregulloren e brendshme dhe në legjislacionin përkatës.

Në Sektorin e Shërbimit Social dhe atë të Qendrave Komunitare dhe NJMF, mungojnë si përgjegjësit ashtu edhe specialistët, duke e lënë bashkinë të paqartë në drejtim të:

- Menaxhimit të rasteve sociale, veçanërisht për fëmijët në rrezik, ku mungon koordinimi ndërinstitutional dhe mbështetja profesionale për grupet e riskuara;
- Hartimit të planeve të zhvillimit të shërbimeve sociale, përfshirë analizën e nevojave, buxhetimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Social Vendor;
- Zhvillimit dhe mbështetjes së shërbimeve në komunitet, për kategori si personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe të rinjtë në situatë rreziku, ku mungon ndjekja e vazhdueshme dhe mbështetja institucionale;
- Mbikëqyrjes së qendrave sociale ekzistuese, vlerësimit të cilësisë së shërbimeve dhe raportimit të rregullt mbi rezultatet dhe impaktin.

Një sfidë shtesë është mungesa e NJV/RN, që përkthehet në mungesë të një strukture funksionale për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e rasteve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Si rrjedhojë, këto funksione po kryhen në mënyrë informale nga administratorët shoqërorë në njësitë administrative, të cilët janë të emëruar për skemat e ndihmës ekonomike dhe jo për mbrojtjen sociale apo ndërhyrjet komplekse. Ata nuk kanë formimin e duhur për trajtimin e rasteve të ndërlikuara, gjë që rrit rrezikun e mosreagimit ose ndërhyrjes joefektive në situata kritike.

Mungesa e burimeve njerëzore të specializuara, kombinimi i roleve të papërcaktueshme dhe mungesa e ndarjes së qartë të përgjegjësisë administrative krijojnë një vonesë sistematike në ofrimin e shërbimeve dhe dobësojnë kapacitetin mbrojtës të strukturave vendore. Pa

një ristrukturim funksional dhe investim të qëndrueshëm në burime njerëzore, Bashkia Pukë rrezikon të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet ligjore dhe standardet minimale të shërbimeve sociale për qytetarët e saj në nevojë

3. Pasojat e mungesës së burimeve njerëzore

Mungesa e burimeve njerëzore të njafueshme dhe të specializuara ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë, shtirjen dhe efektivitetin e shërbimeve sociale në Bashkinë Pukë. Struktura ekzistuese nuk arrin të përmbushë funksionet bazë që parashikohen në legjislacionin për mbrojtjen dhe kujdesin shoqëror, duke prodhuar një sërë pasojash kritike:

- ✓ Shërbimet sociale ofrohen në mënyrë të fragmentuar dhe të kufizuar, duke u përqendruar thuajse vetëm në administrimin e skemave të ndihmës ekonomike, ndërsa ndërhyrjet me natyrë sociale, mbështetëse dhe rehabilituese për grupet vulnerabël mbeten jashtë funksioni;
- ✓ Proceset e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale nuk zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme, për shkak të mungesës së staftit përgjegjës dhe mungesës së kapaciteteve teknike për hartimin dhe ndjekjen e planeve sociale vendore;
- ✓ Mungesa e mekanizmave funksionalë për menaxhimin e rasteve pengon ndjeshëm reagimin institucional ndaj situatave të rrezikut për fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit e vetmuar dhe viktimat e dhunës;
- ✓ Mosfunksionimi i NJVRRN pengon zbatimin e një qasjeje të integruar për vlerësimin dhe referimin e rasteve që kanë nevojë për shërbime të specializuara, duke kompromentuar detyrimet ligjore të bashkisë dhe duke rritur rrezikun për përjashtimin social të kategorive në nevojë.

Për triedhojë, sistemi i mbrojtjes sociale në Bashkinë Pukë funksionon me kapacitete minimale dhe pa instrumentet e nevojshme për të garantuar mbështetje gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme për qytetarët në situatë vulnerabël.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes sociale dhe për të përmbushur detyrimet ligjore, Bashkia Pukë ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme në nivel organizativ dhe burimesh njerëzore:

- ✓ Plotësimi i vendeve bosh në sektorin e Shërbimit Social dhe NJMF; Ngritja funksionale e Njësisë për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje (NJVRRN);

- ✓ Punësimi i specialistëve me profil social për menaxhimin e rasteve, hartimin e planeve dhe ndjekjen e shërbimeve në komunitet;
- ✓ Rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të vazhdueshme, veçanërisht për menaxhimin e rasteve komplekse;
- ✓ Riorganizimi i strukturës ekzistuese, me një ndarje më të qartë funksionesh ndërmjet ndihmës ekonomike dhe komponentëve të ndërhyrjes sociale.

Analiza tregon se Bashkia Pukë përballët me boshllëqe të theksuara në burimet njerëzore, të cilat pengojnë ndërtimin e një sistemi funksional, të koordinuar dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale. Mospërputhja midis strukturës së planifikuar dhe asaj faktike ka krijuar një vakum funksional në sektorët kyç si shërbimi social, njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe strukturat për trajtimin e dhunës në familje. Për pasojë, bashkia ka vëshirësi të mbulojë detyrimet e saj ligjore dhe të ofrojë shërbime sociale cilësore, të bazuara në nevojat reale të qytetarëve. Kjo situatë nënvizon urgjencën për investim të qëndrueshëm në kapacitetet njerëzore dhe për ndërtimin e mekanizmave funksionale për menaxhimin e rasteve në nivel lokal.

4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Pukë

Finalizohet ne fund.

5. Analiza SËOT

Finalizohet ne fund

IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat

Vizioni

Bashkia Pukë synon ndërtimin e një sistemi social gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për çdo qytetar, ku askush nuk mbetet pas dhe çdo individ gëzon dinjtet, mbrojtje dhe mundësi të barabarta për zhvillim.

Misioni

Të garantohet ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, të bazuara në nevojat reale të komunitetit, përmes përfshirjes së strukturave vendore, aktorëve jopublikë dhe vetë qytetarëve në procesin e identifikimit, planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve sociale.

Qëllimi i Planit Social Vendor

Të rritet mirëqenia dhe përfshirja sociale e individëve dhe familjeve në nevojë në Bashkinë Pukë, duke forcuar kapacitetet vendore për të ofruar shërbime sociale gjithëpërfshirëse, të koordinuara dhe të bazuara në evidencë.

Prioritetet Strategjike dhe Objektivat Specifike

Prioriteti 1: Forcimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale

Objektivi 1: Të përmirësohet struktura dhe funksionaliteti i shërbimeve sociale përmes rritjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit profesional.

Masa 1.1: Ristrukturimi dhe përmirësimi i kuadrit institucional për shërbimet sociale.

Aktivitete:

- ✓ A 1.1.1: Rishikimi i strukturës organizative, përcaktimi i roleve sipas funksioneve ligjore dhe miratimi i saj në Këshillin Bashkiak

Tregues:

- Struktura e re organizative e miratuar
- Numri i pozicioneve të reja të shtuar për shërbimet sociale- 2 pozicione te reja

Masa 1.2: Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të shërbimeve sociale.

Aktivitete:

- ✓ A.1.2.1: Vlerësimi i nevojave për trajnim të stafit ekzistues.
- ✓ A.1.2.2: Organizimi i cikleve të trajnimit në bashkëpunim me donatorë dhe institucione arsimore.

Tregues:

- Numri i punonjësve të trajnuar.
- 3 cikle trajnimi të organizuara në vit.

Objektivi 1.2: Të krijohet një sistem monitorimi dhe vlerësimi për performancën e shërbimeve sociale dhe Planit Social Vendor.

Masa 1: Ndërtimi i një mekanizmi të brendshëm të monitorimit dhe vlerësimit.

Aktivitete:

- ✓ A 1.1: Hartimi i një metodologjie për monitorimin e zbatimit të masave të planit.
- ✓ A 1.2 Caktimi i personave përgjegjës në çdo strukturë për raportimin periodik.

Tregues:

- Metodologjia e monitorimit e miratuar.
- Një raport monitorimit i përgatitur në vit.

Masa 2: Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e shërbimeve.

Aktivitete:

- ✓ A 2.1: Krijimi i një databaze për shërbimet sociale dhe grupet në nevojë.

- ✓ A 2.2 Organizimi i trajnimeve për përdorimin e databazës

Tregues:

- Databaza funksionale e të dhënave sociale.
- Numri i trajnimeve të realizuara- 1 trajnim ne vit
- Numri I pjesëmarrësve në trajnim- 10 persona

Prioriteti 2: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale për grupet në nevojë

Objekti 2.1: Të zgjerohet/Vijimesia shërbimet aktuale dhe sigurohet mbulimi dhe cilësia e shërbimeve sociale për PAK dhe të moshuarit në qytet dhe në njësitë administrative. Shërbimet aktuale po vijojne Fondet kane ardhur nga Ministria e Punes dhe Ceshjeve Sociale sipas Projektit te Bashkise Puke per 3 vite 2023-2025.

Do shikohen mundësitë nëse është e mundur të vazhdohet edhe në vijimesi.

Masa 1: Zgjerimi/vijimesia e shërbimeve aktuale

Aktivitet

A 1.1 Krijimi I nje database per sherbimet sociale qe kane personat me PAK dhe te moshuarit ne Qytet dhe Zonat Rurale

Tregues : perfituas 30 te moshuar te moshes 65+

Masa 2 : Zhvillimi i shërbimeve të reja levizëse për PAK dhe të moshuarit.

Aktivitet:

- ✓ A 1.1 Studim për nevojat e PAK dhe të moshuarve për shërbime.
- ✓ A 1.2 Ngritja e shërbimeve pilot në shtëpi.

Tregues:

- Numri i shërbimeve të reja të ngritura për PAK dhe të moshuarit.
- 50 përfutues (të moshuar dhe AK nga zonat rurale) marrin shërbime në shtëpi.

Objekti 2.2: Të përmirësohet sistemi i identifikimit, ndjekjes dhe mbështetjes së fëmijëve në rrezik, të rinjve në situatë të vështirë dhe viktimave të dhunës dhe trafikimit.

Masa 1: Forcimi i NJMF-ve dhe Koordinatorit vendor të dhunës si dhe bashkëpunimit ndërinstitutional për mbrojtjen e fëmijëve dhe viktimave të dhunës.

Aktivitetet:

- ✓ A 1.1 : Trajnime për administratën shoqërore, NJMF dhe Koordinatorin e dhunës mbi identifikimin dhe menaxhimin e rasteve.
- ✓ A 1.2: Mbledhje të rregullta të grupeve ndërsektoriale për rishikimin e rasteve.

Tregues:

- Numri i rasteve të identifikuara dhe ndjekura nga NJMF dhe Koordinatori Dhunës.
- 4 trajnime trajnimeve të zhvilluara në vit.
- 20 Pjesëmarrës në çdo trajnim

Objekti 2.3: Të rritet efikasiteti i ndërhyrjeve sociale për familjet në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

Masa 1: Përmirësimi i aksesit në shërbime të integruara për familjet në nevojë.

Aktivitetet:

- ✓ A.1.1: Krijimi i një mekanizmi referimi dhe ndjekjeje për familjet në nevojë.
- ✓ A 1.2 Ngritja e qendrës multifunksionale për familjet dhe individët në nevojë

Tregues:

- Një qendër e ngritur dhe funksionale.
- 50 familje në nevojë dhe 100 persona marrin shërbime periodike në qendër

Objekti 2.4: Të krijohen ose të forcohen strukturat për menaxhimin e rasteve, përmes ngritjes së NJVRN dhe trajnimit të stafit.

Masa 1: Ngritja e Njesisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) në Bashkinë Pukë.

Aktivitetet:

- ✓ A 1.1: Miratimi i vendimit për ngritjen e NJVRN nga Këshilli Bashkiak.
- ✓ A 1.2: Trajnimi i stafit për funksionimin e NJVRN dhe menaxhimin e rasteve të ndërlikuara.

Tregues:

- NJVRN e ngritur dhe funksionale.
- Një protokoll i hartuar dhe miratuar për funksionimin e NJVRN
- Një trajnim i realizuar
- 15 persona marrin pjesë në trajnim

Prioriteti 3: Fuqizimi i komunitetit dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen sociale

Objekti 3.1: Të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit dhe forcimi i mekanizmave institucionale për mbrojtjen sociale, parandalimin e dhunës, abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve.

Masa 1: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse.

Aktivitetet:

A1.1: Fushata në shkollë për të drejtat e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës dhe abuzimit.

A 1.2 Fushata ndërgjegjësimi në komunitet mbi shërbimet shoqërore të ofruara nga bashkia

Tregues:

- ✓ 26 fushata per te drejtat e femijes dhe parandalimin e dhunes dhe abuzimit me nxenes te shkollave 9 vjecare dhe te mesme
- ✓ 260 nxenes marrin pjese ne fushata
- ✓ 6 fushata ne vit e realizuara ne komunitet (nje ne cdo njesi administrative)
- ✓ 120 i pjesëmarrësve në aktivitetet ndërgjegjëse.

Objekti 3.2: Të rritet qasja në mekanizmat e mbrojtjes për viktimat e dhunës dhe të krijohen shërbime të përshatura në nivel vendor.

Masa .1: Zhvillimi i shërbimeve të përshatura për viktimat e dhunës.

Aktivite:

A 1.1: zbatimi i një protokoll vendor për mbrojtjen e viktimave të dhunës.

A 1.2: Sigurimi i një hapësire të posaçme për ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe ligjore.

Tregues:

- Protokoll vendor i zbatuar.
- Numri i viktimave që përfitojnë shërbime të specializuara.

Objekti 3.3: Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional për parandalimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Masa .1: Forcimi i rrethave ndërinstitucionale për trajtimin e dhunës në familje.

Aktivite:

- ✓ A.1.1: Organizimi i tryezave të përbashkëta me Policinë, Shëndetësinë dhe Arsimin.

- ✓ A.1.2: Trajnime të përbashkëta për menaxhimin e rasteve të dhunës.

Tregues:

- 4 institucione të përfshira në rrjetin vendor.
- 12 raste të trajtuara përmes bashkëpunimit ndërinstitutional.

Objektivi 3.4 Të rritet ndërgjegjësimi dhe njohja mbi mundësitë që ofron modeli austriak për punësimin e personave në nevojë.

Masa 1: Informimi dhe edukimi i stafit të bashkisë, përfituesve dhe aktorëve vendorë mbi modelin austriak të punësimit.

Aktivitetet:

- ✓ A1.1: Organizimi i një seminari informues për modelin austriak dhe mënyrën e zbatimit të tij në Shqipëri.
- ✓ A 1.2: Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të thjeshtuara informuese për publikun dhe përfituesit e mundshëm.
- ✓ A 1.3: Krijimi i një grupi pune për të eksploruar mundësitë e zbatimit të modelit në Bashkinë Pukë.

Treguesit:

- Numri i aktiviteteve informuese të realizuara.
- Numri i pjesëmarrësve në seminare.
- Numri i materialeve të shpërndara.
- Hartimi i një raporti për mundësinë e adaptimit lokal të modelit.

V. Plani i Veprimit

STRATEGJIA E ZBATIMIT

Planifikimi Trevjeçar

Zbatimi i masave prioritare do të jetë i strukturuar dhe i ndarë në faza, me veprime kyçe të shpërndara përgjatë viteve të ndryshme për të garantuar një zbatim sa më efektiv.

Periodha	Veprimet/Aktivitetet
Viti 1 (2025)	➤
Viti 2 (2026)	➤
Viti 3 (2027–2028)	➤

Prioriteti 1: Forcimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale																	
Objektivat	Aktiviteti	Indikator	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	Institucione kontraktues (nëse ka)	Përshkrimi i masave	Njësitë matëse	# Njësitë për produkt	Kosto për njësi Viti 1	Sipas viteve				Burimi i financimit	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit								Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Bashkia	Qeveria/Donatore
Objektivi 1: Të përmbushet struktura dhe funksionaliteti i shërbimeve sociale përmes rritjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit profesional.																	
Masa 1.1: Ristrukturimi dhe përmirësimi i kuadrit institucional për shërbimet sociale.	A 1.1.1: Rishikimi i strukturës organizative, përcaktimi i roleve sipas funksioneve ligjore dhe miratimi i saj në Këshillin Bashkiak	Struktura e re organizative e miratuar	2025	2025	80,100 ALL. Bashkia me fondet e veta	Drejtoria së Ndihmës Ekonomike, Aftësiat së Kufizuar dhe Shërbimet Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore, Drejtoria Juridike	OJF	Staf i bashkisë (3 specialistë x 5 ditë punë)	Ditë Punë	15	80,100	80100				80,100	
			2026	2028	8,280,000 ALL. Bashkia me fondet e veta	Drejtoria së Ndihmës Ekonomike, Aftësiat së Kufizuar dhe Shërbimet Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore, Drejtoria Finances	OJF	Paga për 2 persona x 115,000 ALL/muj personi x 36 muj	muj	72	8,280,000		2760000	2760000	2760000	8,280,000	
Masa 1.2: Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të shërbimeve sociale	A 1.2.1: Vlerësimi i nevojave për trajnim të stafit ekzistues	Një analizë vlerësimi e realizuar	2025	2025	Pa kosto nga bashkia	Drejtoria së Ndihmës Ekonomike, Aftësiat së Kufizuar dhe Shërbimet Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore,	OJF	Pa kosto nga bashkia									
	A 1.2.2: Organizimi i cikleve të trajnimit në bashkëpunim me donatorë dhe institucione arsimore	3 cikle trajnimit të organizuara në vit. Numri i punonjësve të trajnuar	2026	2028		Drejtoria së Ndihmës Ekonomike, Aftësiat së Kufizuar dhe Shërbimet Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore,	OJF	Kosto dieta + transporti për 2 punonjës për trajnim x 3 trajnime në vit x 3 vite (5500 leke dieta +1000 leke transport)	Persona	18	117,000		39000	39000	39000	117,000	

Objekti i 2. Të krijohet një sistem monitorimi dhe vlerësimi për performancën e shërbimeve sociale dhe Planit Social Vendor.																	
Masa 1: Ndërtimi i një mekanizmi të brendshëm të monitorimit dhe vlerësimit.	A 1.1: Hartimi i një metodologjie për monitorimin e zbatimit të masave të plant	Metodologjia e miratuar	2026	2026	150,000 ALL. Fondi social.	Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore,	OJF	Ekspert i jashtëm 1 person x 10 ditë pune x 15000 ALL/dita	Ditë Pune	10	150,000	150000					
	A 1.2: Çakimi i personave përgjegjës në çdo strukturë për raportimin periodik	Një raport monitorimi i përgatitur në vit	2025	2028	Pa kosto nga bashkia	Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve njerëzore,	OJF	Pa kosto nga Bashkia									
	Masa 2: Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e shërbimeve.	A 2.1: Krijimi i një databaze për shërbimet sociale dhe grupet në nevojë	Databaza funksionale e të dhënave sociale	2026	2026	225,000 ALL. Fondi social	Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit Social,	OJF	Ekspert i jashtëm 1 person x 3 ditë pune x 15000 ALL/dita	Ditë Pune	15	225,000	225000				
	A 2.2: Organizimi i trajnimeve për përdorimin e databazës	Një trajnim i realizuar për përdorimin e databazës 10 punonjës të bashkisë aftësohen të përdorin databazën në vitin 2026	2026	2026	90,000 ALL. Fondi social	Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimit Social,	OJF	Ekspert i jashtëm 1 person x 6 ditë pune x 15000 ALL/dita	Ditë Pune	6	90,000	90000					
Total					8,942,100		0				8,942,100	80,100	3,264,000	2,799,000	2,799,000	8,477,100	465,000

Tabela Struktura e shërbimit social në Bashki

Drejtoria	Pozicioni	Nr burimeve njerëzore				Paga Bruto 1 muaj për cdo punonjës
		Plan	Fakt	F	M	
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe çështjeve juridike	Përgjegjës Ndihmë Ekonomike	1	1	1		128,370
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe çështjeve juridike	Specialistë NE dhe PAK	6	6	5	1	490,140
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe çështjeve juridike	Specialistë NJMF dhe KDHF	1	1	1	1	81,960

Përgj. Sek Ndhmës Ekonomike

Lavdie Terbuni



Kryetar

Rrok Dodaj



VI. Finalizimi i Planit Social Vendor

Fleta e Veprimit 1: Prioriteti 1 – Bashkia Pukë

Fleta e Veprimit Nr 2 : Prioriteti 2 – Bashkia Pukë

Fleta e Veprimit 4: Prioriteti 3 – Bashkia Pukë

VII. Monitorimi dhe Vlerësimi(1–2 faqe)

Finalizohet ne fund

VIII Shtojca

Shtojca 1 Kuadri legjislativ

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAË

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Strategjia Territoriale Bashkia Pukë;

- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Pukë.

Shtojca 2 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësis administrative

Grafiku paraqet rrjetin e aktorëve institucionalë dhe komunitarë që mbështesin kategoritë në nevojë në nivel lagje/fshat, bashkie dhe qarku. Ai shërben si mjet orientues për profesionistët e shërbimeve sociale, duke i ndihmuar të përdorin në mënyrë efektive burimet ekzistuese për parandalimin, referimin dhe mbështetjen e rasteve vulnerabël.

Rrathët koncentrikë përfaqësojnë nivelet e ndërhyrjes: i) Rrethi i brendshëm: niveli lokal/komunitar; ii) Rrethi i mesëm: niveli bashkiak; iii) Rrethi i jashtëm: niveli rajonal dhe kombëtar. **Ngjyrat** tregojnë institucionet dhe aktorët komunitarë përkatës, të cilët janë të pranishëm në nivele të ndryshme. Aktorët me të njëjtën ngjyrë përfaqësojnë të njëjtin institucion apo funksion në formatin e tij lokal, bashkiak dhe rajonal.

IX ANEKSE

Përgjegjëse Ndihtmes Ekonomike

Lavdie Terbuni

Kryetar

Rrok Dodaj